



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .11.2023

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga z. A.S  
Adresa:

**TIRANË**

I nderuar z. S,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 1870 prot datë 31.10.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me anë të së cilës në referencë të nenit 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkohet kopje e njësuar e dosjes hetimore 12389-A të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, me nr vendimi 113 datë 29.12.1982 si edhe dosjen gjyqësore së bashku me vendimin e Gjykatës Kukës për dënimin e shtetasve, R.E., B.Gj., Sh.Gj., Xh.Gj., A.Gj., Sh.D., M.S. dhe H.V., me arsyetimin se dokumentet e paraqitura në një kronikë të televizionit ABC NEWS në datat 12-13 maj 2023 janë marrë nga Autoriteti, ju informojmë se:

Së pari baza ligjore në kërkesën tuaj për informacion, është vendosur bazuar në nenin 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit“.

Por nga shqyrtimi i objektit të kërkesës vërehet se kërkesa juaj për informacion i nënshtrohet dhe rregullohet nga dispozitat e ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar.

Ligji organik nr. 45.2015 normon veprimtarinë funksionale të Autoritetit, si ligj i posacëm, që gjen zbatim duke prevaluar mbi ligjin nr. 119.2014, i cili zbatohet për atë që është e mundur dhe nuk bie ndesh me ligjin organik, por edhe me ligjin për arkivat pasi informacioni që kërkohet për vënie në dispozicion është dokumentacion arkivor.

Kërkesa juaj për informim i nënshtrohet dispozitave procedurale për mënyrën se si të aksesohet informacioni, sipas dispozitave njohëse dhe kufizuese të ligjit nr. 45/2015.

Ligji nr. 45/2015, përcakton qartë subjektet kërkues që mund të kenë qasje në informacion, objektin, qëllimin dhe përdorimin e informacionit, të drejtat e kërkuesve, mbrojtjen e palëve të prekura apo të tretëve si dhe kriteret e përdorimit të informacionit.

Sipas Nenit 20 të ligjit nr. 45/2015

**Garantimi i së drejtës për informim**

1. Kërkuesit i njihet e drejta për t’u njohur me dokumentet *kur ai ka cilësinë e të prekurit, palës së tretë, bashkëpunëtorit apo të favorizuarit* të ish-Sigurimit të Shtetit ose është një përfaqësues me prokurë i këtyre të fundit. Kjo e drejtë përfshin njohjen dhe shqyrtimin e dokumenteve origjinale ose dublikatave të tyre.

Sa më sipër çdo individ në cilësinë e kërkuesit ka mundësi të aplikojë për informacion në Autoritet, për veten ose të afërmit të tij brenda parashikimit të ligjit 45/2015, duke plotësuar formularin përkatës të miratuar nga Autoriteti.

Në Nenin 34 të ligjit nr. 45/2015 parashikohet se

“Informacionet që lidhen me persona, të marra në përputhje me parashikimet e këtij kreu, përdoren vetëm për qëllimet për të cilat janë kërkuar, përveçse kur parashikohet ndryshe nga ky ligj”.

Në këtë kuadër kërkesa juaj, në referencë të nenit 20, është përcjellë në strukturën përkatëse për tu trajtuar në përputhje me rregullat dhe procedurat ligjore që kërkon neni specifik. Për ecurinë e praktikës, do të njoftoheni nga strukturat përkatëse.

Gjithashtu ju informojmë se dokumentacioni i sipërcituar është vënë në dispozicion subjektit kërkues në cilësinë e medias në bazë të nenit 36, pika ç, 37 dhe 38 të Ligjit nr. 45/2015 i ndryshuar.

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Financave**

**Sofi Noti**

Konceptoi:

L.Cocoli

Datë:

03.11.2023